

**Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil merr pjesë në një leksion të hapur me studentët e Universitetit “Marin Barleti”**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u ftua në ambjentet e Universitetit “Marin Barleti”, për një leksion të hapur me studentë, të interesuar për të njohur më mirë institucionin që kryen mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil.



Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, znj. Lefterije Lleshi (Luzi) falënderoi themeluesit dhe trupën pedagogjike për kontributin e dhënë në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe theksoi rëndësinë e afrimit të institucioneve publike me botën

akademike, për të ndërtuar një administratë profesionale dhe në përputhje me standardet evropiane.



Studentët adresuan pyetje mbi proceset e rekrutimit në administratën publike dhe mbi rolin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në përgjigje të pyetjeve të tyre, Komisionerja i njohu ata me objektin e veprimtarisë së institucionit dhe me vizionin e saj për digjitalizimin e sistemit të mbikëqyrjes së shërbimit civil dhe unifikimin e të gjitha procedurave që kanë lidhje me zbatimin e ligjit “Për nëpunësin civil.

Komisioneri inkurajoi studentët që të marrin pjesë në procesin e rekrutimit dhe në programet e trajnimit që ofrohen nga KMSHC.

Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, z. Arbi Agalliu së bashku me Përgjegjësen e Departamentit të Drejtësisë, znj. Elisabeta Imeraj, falënderuan Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për njohuritë e ndara me studentët dhe trupën pedagogjike dhe shprehën interes që praktikatat mësimore të zhvillohen pranë



KMSHC-së dhe që studentët të kenë mundësi të bëjnë edhe internship-e në institucionet që mbikëqyr Komisioneri.



Në përmbyllje të leksionit të hapur, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Universiteti “Marin Barleti” u dakordësuan që në të ardhmen të nënshkruajnë edhe një marrëveshje bashkëpunimi.